



# Fuqizimi i artistëve të rinj teatrorë

## THIRRJE E HAPUR

Teatri ODA është një teatër profesionist i pavarur, i përkushtuar në zhvillimet profesionale e bashkëkohore të artit dhe kulturës, e në veçanti të artit teatror. Duke synuar krijimin e hapësirës promovuese dhe stimuluese për gjeneratat e reja të profesionistëve teatrorë, Teatri ODA përmes kësaj thirrjeje të hapur do të ofrojë hapësirë dhe mbështetje për promovimin e punës së artistëve të rinj dhe grupeve të reja dhe atyre në fillim të karrierës në fushën e teatrit.

Ftohen artistët e rinj dhe grupet e reja në fillim të karrierës, që të aplikojnë me projektet e tyre teatrorë që të përfitojnë mundësinë e shfaqjes publike në skenën e Teatrit ODA, përfshirë edhe mbështetjen teknike si dhe konsulencë e mentorim në aspektet e zhvillimit të mëtejshëm të punës së tyre, menaxhimit, zhvillimit artistik, gjetjes së fondeve dhe komunikimin efikas me publikun.

### **Kriteret:**

Për qëllimin e kësaj thirrjeje, artistë të rinj, grupe të reja dhe artistë apo grupe në fillim të karrierës konsiderohen: studentët e profileve përkatëse të Teatrit të nivelit Bachelor, vitet II, III dhe IV, të nivelit Master, të diplomuarit para jo më shumë se 3 viteve, por të cilët nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme dhe hapësirë të nevojshme për ekspozimin publik të punëve dhe projekteve të tyre teatrorë deri më tash.

### **Projektet teatrorë me të cilat aplikohet duhet:**

- të jenë të përfunduara plotësisht në kuptimin e zhvillimit artistik të projektit, apo planifikohen të përfundohen më së largu deri më 31 janar 2024;
- të kenë ekip të kompletuar artistik, dhe të gatshëm për shfaqje publike;
- të kenë fleksibilitet dhe gatishmëri për shfaqje publike në orarin e përcaktuar nga Teatri ODA në periudhën pasuese deri më 31 mars 2024.

### **Përfitimet:**

Aplikuesit e suksesshëm dhe të përzgjedhur do të përfitojnë:

- Provë teknike dhe provë gjenerale (dita para shfaqjes publike apo edhe më shumë, varësisht prej mundësive) në skenën e Teatrit ODA
- Shfaqjen publike të shfaqjes teatrorë në skenën e Teatrit ODA
- Konsulencë dhe mentorim për projektin apo projektet e tyre në aspektet e: menaxhimit, zhvillimit artistik, gjetjes së fondeve dhe komunikimit me publikun.

- Mbulim të shpenzimeve teknike, të nevojshme për shfaqjen publike (deri në vlerën 700 EUR përmes pagesës së drejtpërdrejtë të shpenzimeve nga ana e Teatrit ODA të ofruesit e materialeve apo shërbimeve)

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Dosja e projektit: Të dhënat për tekstin, konceptin dhe vizionin regjisorial, ekipin e aktorëve dhe të bashkëpunëtorëve kreativë (në formatin PDF, jo më shumë se 5 faqe).
2. Dosja teknike e projektit: Të dhënat për specifikat teknike të shfaqjes përfshirë skenën, kostumet, rekuizitat, ndriçimin, muzikën dhe aspekte tjera teknike të shfaqjes të shoqëruara me skica dhe fotografi (në formatin PDF, jo më shumë se 7 faqe)
3. CV apo portofolio e bartësit të projektit i cili aplikon në këtë thirrje (në formatin PDF);
4. Dëshmi mbi vijueshmërinë e studimeve apo diploma në programin përkatës për Teatër (në formatin PDF);

Aplikimi bëhet në këtë link:

<https://forms.gle/HJjATF9snQvPZerI7>

Afati i fundit për aplikim:

**E diel, 21 janar 2024, ora 17:00**

Aplikimet pranohen vetëm përmes likut të ofruar, aplikimet pas afatit dhe aplikimet e pa kompletuara dhe me mangësi serioze të informatave të kërkuara nuk do të konsiderohen për përzgjedhje.

Aplikuesit e përzgjedhur do të kontaktohen nga Teatri ODA, më së largu deri më 25 janar për koordinim të orarit dhe aspekteve tjera organizative të shfaqjes publike.

*Fuqizimi i artistëve të rinj teatrorë është një prej shtyllave të Programit Vjetor të Teatrit ODA, përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Komuna e Prishtinës*



Republika e Kosovës  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe  
Sportit



PRISHTINA  
KOMUNA E  
PRISHTINËS